

VENDIM
Nr.922, datë 2.7.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË FIER TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Fier të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Fier të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.831, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Fier, të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Fier

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5, 7-12	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
13,15-43	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14,89-92	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
52,53,54,55,56	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
59-73	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
93	Varreza publike	Në pronësi
94,95,100-505,506-565,602	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

566-601	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
617-776	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
74-88,96-98,777-793,803-825	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
794,798,800	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
795-797,799	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi